

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 31.07.2025, merr këtë:

VENDIM NR.41/2025/KG

për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, e mbajtur më datën 23.06.2025

Neni 1

Miratohet procesverbali nga mbledhja e gjashtë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 23.06.2025.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e gjashtë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 23.06.2025.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević
Milan Dimitrijević



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e gjashtë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 23.06.2025 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën 13:30.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje nga 19 asamblistë janë të pranishëm 17 asamblistë dhe ka kuorum, ndërsa mungojnë: Dejan Jevtiq dhe Zoran Danilloviq. Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësuesit të KFOR-it, kryetarja e Komunës së Graçanicës, Kabineti i kryetares së komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale: të Buxhetit dhe Financave, të Arsimit dhe Kulturës, të Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente, pastaj shefi i Prokurimit Publik, zyrtarja nga Drejtoria e Inspektionit, mediat, Shërbimi për Përkthim, Shërbimi për Informim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e gjashtë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzëri e ka dhënë mendimin pozitiv për rendin e ditës të propozuar me dy pikë plotësuese.

Kryesuesi tha se pas caktimit të mbledhjes janë pranuar dy kërkesa për plotësimin e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për anulimin e Vendimit nr.2405/21 të datës 26.05.2021 (Nr.29-2021-KG) për shpalljen e parcelës nr.909-26 ZK Çagllavicë me interes të përgjithshëm publik, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të komunës, Millan Dimitrijeviq.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës për parcelat nr. 1998/2, 1999/1, 1999/2, 2007/1, 2007/2, 2008/1, 2008/1 dhe 2008/3 ZK Graçanicë, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të komunës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi e hodhi në votim plotësoimin e rendit të ditës me dy pikë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve "Pro", miratoi propozimin për plotësimin e rendit të ditës.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e propozuar të ditës me plotësimin e miratuar.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve "Pro", miratoi rendin e mëposhtëm të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e rregullt, e mbajtur më datën 04.06.2025.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komunës së Graçanicës për periudhën 01.12.2024 – 31.05.2025, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit për periudhën 01.12.2023-01.12.2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Strahinja Artonoviq.
5. Shqyrtimi i kërkesës për ndryshimin e emrit ekzistues të kompleksit sportiv në Graçanicë, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Strahinja Artonoviq.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Inspekcionit të Ndërtimit dhe të Bujqësisë për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Inspekcionit, Marko Arsiq.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Inspekcionit të Tregut, të Shërbimeve Publike dhe të Mbrojtjes së Mjedisit për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Inspekcionit, Marko Arsiq.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për anulimin e Vendimit nr.2405/21 të datës 26.05.2021 (Nr.29-2021-KG) për shpalljen e parcelës nr.909-26 ZK Çagllavicë me interes të përgjithshëm publik, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të komunës, Millan Dimitrijeviq.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës për parcelat nr. 1998/2, 1999/1, 1999/2, 2007/1, 2007/2, 2008/1, 2008/1 dhe 2008/3 ZK Graçanicë, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të komunës, Millan Dimitrijeviq.
10. Shqyrtimi i Raportit për realizimin e Planit vjetor të prokurimit publik dhe kontratave të nënshkruara për vitin 2024, me propozim të shefit të Prokurimit Publik, Dejan Todoroviq.
11. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e rregullt, e mbajtur më datën 04.06.2025.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komunës së Graçanicës për periudhën 01.12.2024 – 31.05.2025, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Kryetarja e Komunës së Graçanicës, prof. dr. Ljiljana Shubariq, e prezantoi raportin gjashtëmujor mbi punën e Komunës së Graçanicës për periudhën dhjetor 2024 - maj 2025. Znj. Shubariq tha se qeverisja lokale, pavarësisht sfidave të shumta, ka treguar një nivel të lartë të organizimit, rezultatet konkrete dhe shërbimet e përmirësuara për qytetarët.

Kryetarja Shubariq foli për secilën drejtori veç e veç, ndërsa vuri theks të veçantë në projektet e shumta infrastrukturore, projektet e realizuara në shëndetësi dhe arsim.

“Ndër projektet më të rëndësishme janë ndërtimi i ndërtesës së banimit social në Llapllasellë, rindërtimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale në disa vendbanime, rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, ndërtimi i qendrës edukative dhe rekreative në Graçanicë. Ne blemë një automjet sanitar dhe një aparat për dializë, ndërsa kur bëhet fjalë për arsimin, i pajisëm kabinetet e shkollave, blemë kompjuterë dhe pajisje të tjera, ndërtuam ndërtesa ndihmëse shkollore e të ngjashme. E gjithë kjo tregon se Graçanica vazhdon të rritet si një qeveri lokale institucionalisht e qëndrueshme dhe qytetarisht përgjegjëse”, tha kryetarja Shubariq.

Asamblisti Nebojsha Markoviq, para partisë “SRPSKA”, tha se raporti tregon se është bërë shumë. Në Çagllavicë, ku jetoj unë, janë shtruar tre rrugë vitin e kaluar, është instaluar rrjeti i ujësjellësit dhe jam më shumë se i kënaqur. Mendoj se edhe Këshilli lokal i Çagllavicës, anëtar i të cilit jam, ka kontribuar në këtë, sepse ne mbajmë rregullisht takime dhe bëjmë propozime për zbatimin e projekteve të caktuara në prezantimet e buxhetit.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, tha se e mbështet raportin e kryetares së komunës. Në Llapllasellë ende ekziston problemi ekologjik lidhur me lumin dhe shpresoj se do të zgjidhet në të ardhmen.

Kryesuesi tha se Komuna e Graçanicës ka bërë shumë, veçanërisht në sistemin shkollor, ku, përmes Drejtorisë së Arsimit, ka zbatuar një numër të madh projektesh lidhur me pajisjen e shkollave. Ai e vlerësoi punën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, e cila është gjithmonë në dispozicion, ndërsa drejtori Vlladica Trajkoviq mund të shpërblehet.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 16 asamblistëve “Pro”, dhe 1 votë “Kundër” të Granit Gashiq, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:II

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Asamblisti Granit Gashi mungon në mbledhje, gjithsej janë të pranishëm 16 asamblistë dhe ka kuorum.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, e paraqiti Kornizën afatmesme buxhetore 2026-2028, duke u bazuar në Qarkoren e parë buxhetore. Ai theksoi se buxheti i planifikuar i Komunës së Graçanicës për vitin e ardhshëm është 12.530.000 euro, për vitin 2027 është 13.188.000 euro dhe për vitin 2028 është 13.716.000 euro.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 16 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit për periudhën 01.12.2023-01.12.2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Strahinja Artonoviq.

Drejtori i Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Strahinja Artonoviq, tha se do ta paraqesë raportin për periudhën 01.12.2023 - 01.12.2024, edhe pse në këtë periudhë nuk e kryente funksionin e drejtorit të Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit. Drejtori e paraqiti raportin e bashkangjitur në detaje dhe në fund theksoi informacionin e mëposhtëm: Drejtoria e Rinisë dhe Sportit pranoi dhe zbatoi 80 kërkesa dhe atë nga dhënia me qira të sallës së mbyllur në Kompleksin sportiv "Dragan Xhaji", deri te pagesa e një shumë prej 800 eurosh, si dhe shumë prej 430 euro për Qendrën e fitnesit "Colosseum" në Sallën sportive në Llaplasellë për periudhën 01.06.2024 deri më 01.12.2024, që arrin në një total prej 1230 eurosh.

Kryesuesi tha se drejtori i mëparshëm i Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Dushan Cvejiq, bëri një punë të shkëlqyer, ku nuk kishte shumë fonde dhe megjithatë arriti të bënte kaq shumë aktivitete që meritojnë çdo lavdërim dhe shpreson që drejtori Artonoviq do ta vazhdojë këtë vazhdimësi si drejtori i mëparshëm.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", tha se pavarësisht të gjitha sugjerimeve të mëparshme, një pjesë e buxhetit për mallra dhe shërbime ende nuk është ndarë për Drejtorinë e Rinisë dhe Sportit dhe mendon se kjo duhet të ndryshojë në të ardhmen, në mënyrë që drejtoria të funksionojë në mënyrë të pavarur.

Asamblisti Nebojsa Markoviq, para partisë "SRPSKA", e vlerësoi raportin e Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, duke rënë dakord me asamblisten Jovanoviq që drejtoria duhet ta ketë buxhetin e vet. Ai i kërkoj drejtorit zëvendësimin e stolave për lojtarët rezervë në Kompleksin sportiv "Dragan Xhaji", si dhe karriget që ishin thyer.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 16 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i kërkesës për ndryshimin e emrit ekzistues të kompleksit sportiv në Graçanicë, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Strahinja Artonoviq.

Drejtori i Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Strahinja Artonoviq, tha se ka pranuar një kërkesë nga Vlastimir Ivanoviq nga njerëzit që e inicuan peticionin për ndryshimin e emrit të Kompleksit sportiv në Graçanicë në "Graçanicë". Shumica dërmuese e atyre që nënshkruan peticionin nuk kanë asgjë kundër Dragan Xhaji, i cili ka bërë shumë për futbollin serb dhe si rezultat është president i FFS-së.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë "SRPSKA", pyeti se sa nënshkrime kishte në peticion.

Drejtori i Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Strahinja Artonoviq, u përgjigj se janë 234 nënshkrime.

Kryesuesi shpjegoi se një nga arsyet pse emri duhet të ndryshohet është se ata nuk mund ta gjenin vendimin e Kuvendit të komunës për emërtimin e atij kompleksi sportiv në arkivat e

Shërbimit të Kuvendit dhe arsyeja e dytë është se kompleksi sportiv mban emrin e një personi të gjallë.

Asamblisti Millosh Todoroviq, para partisë “SRPSKA”, e mbështeti propozimin për ndryshimin e emrit të Kompleksit sportiv në “Graçanicë”, sepse do të ishte shumë më i famshëm dhe do të kishte një gjerësi më të madhe, sesa, për shembull, emërtimi i kompleksit sportiv sipas ndonjë qytetari (sportisti) të njohur.

Asamblisti Nebojsa Markoviq, para partisë “SRPSKA”, tha se Dragan Xhajiç është një legjendë e futbollit jugosllav, botëror dhe serb dhe mendoj se tani është e kotë të ndryshohet emri me një peticion.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 9 asamblistëve “Pro”, 1 votë “Kundër” të Nebojsa Markoviqit dhe 6 vota “Apstenim” të Dushan Borisavljeviqit, Dragan Maksimoviqit, Biljanës Kapetanoviq, Jellenës Dimitrijeviq, Ljubisha Karaxhiqit dhe Vlladica Qurçiqit, miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Inspekcionit të Ndërtimit dhe të Bujqësisë për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Inspekcionit, Marko Arsiq.

Kryesuesi tha se drejtori i Inspekcionit mungon arsyeshëm, kështu që raportet do t'i paraqesë Alleksandra Bllanusha, inspektorja e mbrojtjes së mjedisit.

Alleksandra Bllanusha, inspektorja e mbrojtjes së mjedisit, tha se inspektorja e bujqësisë kryen inspektime të përditshme në terren, të gjitha me qëllim të parandalimit të keqpërdorimit të tokës bujqësore. Me kërkesë të qytetarëve, ajo e kontrollon numrin e koshereve të bletëve me qëllim të subvencionimit të fermerëve që merren me bletari dhe prodhimin e mjaltit. Në vitin 2024, u përpiluan 22 procesverbale për ndërprerjen e përdorimit të tokës bujqësore për qëllime jobujqësore dhe gjithsej 56 procesverbale të tjera. U hartuan 11 vendime për ndërprerjen e përdorimit të tokës bujqësore dhe gjithsej 61 vendime. U paraqitën 8 kërkesa për fillimin e procedurave kundërvajtëse dhe pati 3 ankesa nga qytetarët.

Inspektorja e ndërtimit përpiloi gjithsej 120 procesverbale, 22 vendime për pezullimin e punimeve ndërtimore, 22 vendime për rrënim, 23 vendime për shqiptimin e gjobave, 3 për legalizim, 3 vendime për iniciimin e kontesteve gjyqësore dhe pranoi 9 ankesa kundër aktvendimeve. Për mosrespektimin e ligjit, u lëshuan 23 gjoba mandatore prej 500 eurosh secila, që është një total prej 11,500 eurosh.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 15 asamblistëve “Pro” dhe 1 votë “Apstenim” të Biljanës Kapetanoviq, miratoi pikën e gjashtë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Inspekcionit të Tregut, të Shërbimeve Publike dhe të Mbrojtjes së Mjedisit për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Inspekcionit, Marko Arsiq.

Alleksandra Bllanusha, inspektorja e mbrojtjes së mjedisit, tha se Drejtoria e Inspekcioni ka 5 shërbime të inspekcioni, ndërsa deri 2-3 vjet më parë ata kishin edhe Inspekcionin sanitar, i cili sot funksionon në Ministrinë e Shëndetësisë.

Inspekcioni i Tregut merret kryesisht me mbrojtjen e konsumatorit dhe rregullimin e tregut, që përfshin kontrollin e shfaqjeve të çmimeve, faturimit, sigurisë së produkteve, datave të skadimit dhe rregullimin e orarit të punës. Numri i përgjithshëm i procesverbaleve të përpiluara është 138, ndërsa janë marrë 124 vendime për pëlqimin teknik të bizneseve të sapohapura dhe 9 shënime zyrtare për marrjen në dorëzim dhe zgjidhjen e lëndëve.

Inspekcioni i Shërbimeve Publike ose Inspekcioni komunal është përgjegjës për kontrollin e rrugëve dhe trotuareve të qytetit, kontrollin dhe parandalimin e derdhjeve të ujërave të zeza në zonat publike, kontrollin e zënieve të paligjshme të zonave publike dhe kontrollin e taksive. Në total, ata përpiluan 14 procesverbale, 5 shkresa dhe 1 vendim që vendoste një gjobë të detyrueshme.

Inspekcioni i Mbrojtjes së Mjedisit e viziton terrenin çdo ditë me qëllim të parandalimit të hedhjes së paligjshme të mbeturinave, djegies së mbeturinave, ndotjes së mjedisit, si dhe kontrollojmë lejet mjedisore të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit. Janë përpiluar gjithsej 78 procesverbale, janë marrë 3 vendime për pezullimin e aktiviteteve të objekteve dhe bizneseve që nuk kanë leje mjedisore. Janë lëshuar gjithsej 7 gjoba në vlerë prej 2020 eurosh, 4 gjoba në vlerë prej 635 eurosh të paguara brenda afatit me një ulje prej 50%, është mbledhur 1 gjobë në vlerë prej 50 eurosh, dhe 2 gjoba prej 700 eurosh janë në procedurë. Kemi problem me mbledhjen e gjobave, ndërsa komuna është e detyruar të gjejë një mënyrë për të mbledhur dhe gjobisë personat që nuk paguajnë brenda afatit të përcaktuar ligjor. Deri më tani, këto gjoba i kemi dërguar në gjykatë dhe më pas tek përmbaruesit, por kemi marrë një përgjigje me shkrim nga përmbaruesit se kjo nuk është më në juridiksionin e tyre. Kur gjobim një person që vjen nga territori i Komunës së Graçanicës, nuk ka problem sepse komuna mund ta sanksionojë atë person në formën e moslëshimit të një dokumenti derisa të paguajë gjobën. Konkretisht, kemi problem me vendosjen e gjobave për kamionët që hedhin mbeturina këtu dhe vijnë nga komuna të tjera.

Alleksandra Bllanusha, inspektorja e mbrojtjes së mjedisit, tha se solli me vete një raport, të cilin e bënë në vitin 2021, në lidhje me ndotjen e lumit Graçanka në Llapllasellë. Inspekcioni është marrë me këtë problem që nga viti 2014-2015. Inspekcioni i Mbrojtjes së Mjedisit i ka kërkuar vazhdimisht Ministrisë së Mjedisit t'i kryejë analizat e lumit Graçanka dhe të gjitha analizat kanë treguar se nuk ka asgjë të dëmshme për shëndetin e qytetarëve atje, përveç ujërave të zeza të zakonshme. Inspektorët e Ministrisë së Mjedisit u përgjigjën disa herë dhe dolën në terren me ne, sepse këto ujëra të zeza vijnë nga territori i Komunës së Prishtinës, më saktësisht nga Hajvalia, dhe derdhen në lumin tonë. Inspekcioni komunal nuk ka autoritet për të kryer kontroll në territorin e një komune tjetër, dhe në atë pjesë të territorit të Komunës së Graçanicës nuk kemi asnjë biznes të vetëm ose ndotës të madh, dhe nëse ka një, ai mund të vijë nga territori i komunës fqinje. Për këtë arsye, ne i thirrëm inspektorët nga Komuna e Prishtinës, zhvilluam biseda me përfaqësues të Avokatit të Popullit, përfaqësues të KFOR-it, dhe Stacioni i policisë në Graçanicë hapi një rast. Morëm përgjigje dhe raporte nga të gjithë me përfundimin se nuk ka ndotës, se nuk ka agjent shkaktar dhe se është sistemi i kanalizimit që, për shkak të rënies së nivelit të lumit, shkakton një erë të shtuar dhe se duhet të kryhet një projekt i përbashkët me Komunën e Prishtinës, Komunën e Fushë Kosovës dhe Ministrinë e Mjedisit, i cili do të pastronte lumin.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti a janë bërë testet kur lumi ishte i kuq, blu.

Alleksandra Bllanusha, inspektorja e mbrojtjes së mjedisit, u përgjigj se ajo personalisht nuk e ka parë atë ngjyrë të lumit dhe se e ka parë vetëm kur lumi ishte i bardhë. Kur lumi ishte i bardhë, ne i thirrëm autoritetet nga ministria që të vinin, por kur mbërritën pas 2-3 orësh, lumi ishte pastruar.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti nëse komuna mund të punësojë një laborator privat për ta testuar përmbajtjen e ujit në lumë, sepse nuk mund të presim që Prishtina ta zgjidhë këtë problem për ne.

Alleksandra Bllanusha, inspektorja e mbrojtjes së mjedisit, u përgjigj se në një moment u formua një grup pune brenda Komunës së Graçanicës, i cili përfshinte si qytetarët ashtu edhe kryetarin e fshatit dhe ne arritëm në përfundimin se një analizë duhet të bëhet nga një terren neutral, dhe më pas e paraqitëm të njëjtën kërkesë në Kabinetin e kryetarit të mandatit të mëparshëm.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, tha se ishte e çuditshme që lumi ishte i pastër në një pjesë të vitit dhe i turbullt në një tjetër. Ai sugjeroi që administrata e ardhshme komunale të ndajë fonde nga buxheti derisa të zgjidhet problemi me sistemin e kanalizimit, sepse më parë në atë lumë kishte peshq, por tani nuk ka as bretkosa.

Asamblisti Vlladica Qurçiq, para partisë “SRPSKA”, tha se komuna duhet ta kryejë vetë një analizë të ujit, në mënyrë që të krijojë presion. Ne e bëmë këtë kur kishte prani të manganit në ujë, por askush nga komuna nuk solli një dokument që të tregonte se sa mangan ishte i pranishëm në ujë, dhe ata vetëm thanë se prania ishte e shtuar, ndërsa një sasi e madhe e manganit mund të çojë në dëmtime serioze në trurin e fëmijëve.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 16 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e shtatë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për anulimin e Vendimit nr.2405/21 të datës 26.05.2021 (Nr.29-2021-KG) për shpalljen e parcelës nr.909-26 ZK Çagllavicë me interes të përgjithshëm publik, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të komunës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi shpjegoi se kishin pranuar një kërkesë nga përfaqësuesi ligjor i komunës që Kuvendi i komunës ta anulojë këtë vendim, sepse komuna e kishte fituar çështjen në gjykatë kundër personave që e kishin paditur komunën dhe se vendimi do të ishte ligjërisht i detyrueshëm.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 13 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e tetë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës për parcelat nr. 1998/2, 1999/1, 1999/2, 2007/1, 2007/2, 2008/1, 2008/1 dhe 2008/3 ZK Graçanicë, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të komunës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi e lexoi kërkesën që e pranuan nga Mitropoliti i Rashkës dhe i Prizrenit.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 16 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e nëntë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i Raportit për realizimin e Planit vjetor të prokurimit publik dhe kontratave të nënshkruara për vitin 2024, me propozim të shefit të Prokurimit Publik, Dejan Todoroviq.

Shefi i Prokurimit Publik, Dejan Todoroviq, tha se vitin e kaluar tha gjithashtu se Shërbimi i Prokurimit është pjesë e Drejtorisë së Administratës dhe se nuk duhet t’i shpjegojë raportet në mbledhjet e Kuvendit të komunës. Gjithashtu vitin e kaluar thashë se dera është gjithmonë e hapur për asamblistët e Kuvendit të komunës, por në një vit asnjë asamblist nuk ka ardhur të më pyesë për prokurimin.

Kryesuesi pyeti a janë realizuar plotësisht prokurimet publike në vitin 2024.

Shefi i Prokurimit Publik, Dejan Todoroviq, u përgjigj se ato nuk janë zbatuar, sepse kishte pagesa të detyruara dhe disa projekte u sakrifikuan, siç është ndërtesa e Ekologjisë dhe disa projekte më të vogla.

Kryesuesi pyeti nëse këto projekte që nuk u zbatuan në vitin 2024 ishin parashikuar në planin e prokurimit publik për vitin 2025.

Shefi i Prokurimit Publik, Dejan Todoroviq, u përgjigj se nuk janë paraparë.

Asamblisti Vlladica Qurçiq, para partisë “SRPSKA”, tha se vitin e kaluar kanë marrë një aparat për dializë dhe se plani është të ndërtohet një objekt në vitin 2026 dhe pyeti nëse ky informacion është i saktë.

Shefi i Prokurimit Publik, Dejan Todoroviq, u përgjigj se kishte marrë një kërkesë nga Drejtoria e Shëndetësisë për ta kryer prokurimin për atë pajisje, prokurimi është kryer dhe unë nuk i di planet e mëtejshme. Unë nuk marr pjesë në zhvillimin e planit të prokurimit dhe vetëm duhet ta zbatoj atë, prandaj propozoj të hapet një Drejtori të Prokurimit dhe të ndryshohet Statuti i komunës, në mënyrë që ai t’u përgjigjet drejtpërdrejt asamblistëve të Kuvendit të komunës dhe kryetarit të komunës.

Asamblisti Vlladica Qurçiq, para partisë “SRPSKA”, tha se nuk është humane ndaj pacientëve ta blejnë pajisjen 2 vjet më parë dhe të presin 2 vjet që të ndërtohet ndërtesa, sepse pajisja do të jetë e vjetër deri atëherë.

Shefi i Prokurimit Publik, Dejan Todoroviq, u përgjigj se asamblisti Qurçiq kishte plotësisht të drejtë. Ai tha se QKS-ja refuzoi ta pranonte pajisjen, duke përmendur mungesën e stafit profesional dhe hapësirës

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, tha se problemi qëndron te drejtori i QKS-së, i cili nuk e kreu procedurën. Nëse nuk kanë një kontejner, unë do të sigurohem që ai të përshtatet në mënyrë që të sëmuret të mos shkojnë në Mitrovicë, Nish ose Vranje për dializë.

Kryesuesi tha se ishte personalisht i pranishëm kur kryetarja Shubariq telefonoi QKS-në në Mitrovicë, ku mjeku që punonte në dializë tha se nuk ishte problem për të që të vinte për 6



muaj, të bënte kontrole dhe të jepte terapi, dhe se ishte e nevojshme të trajnoheshin vetëm 8 teknikë.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e njëmbledhjetë të rendit të ditës:

11. Të ndryshme.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 15:06.

Procesmbajtësi
Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit të Komunes së Graçanicës

Milan Dimitrijević